



Gjithçka që duhet ta keni!

**KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS PËR SIGURIMIN E MALLRAVE
NË UDHËTIM (CARGO)**

Prishtine, Korrik 2016

Në bazë të nenit 38 të Statutit të kompanisë së sigurimeve “ Elsig” sh.a. Bordi i drejtorëve i Kompanisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur me Korrik 2016 miratoi Kushtet e sigurimit të MALLRAVE NË UDHËTIM (CARGO).

Permbajtja:

Neni 1	Format e Mbulimit
Neni 2	Mbulimi i rrezikut C
Neni 3	Mbulimi i rrezikut B
Neni 4	Mbulimi i rrezikut A
Neni 5	Përjashtimet në të 3 (tre) Format e mbulimit
Neni 6	Mjetet e Transportit
Neni 7	Pjesa e Zbritshme
Neni 8	Përmbajtja e Kërkesës
Neni 9	Detyrimet e të Siguruarit
Neni 10	Lidhja e Kontratës
Neni 11	Primi i Sigurimit
Neni 12	Fillimi dhe perfundimi
Neni 13	Vonesa
Neni 14	Vlera e sigurimit
Neni 15	Shuma e siguruar
Neni 16	Sigurimi i pjesshëm
Neni 17	Paraqitja e të dhënave
Neni 18	Ndryshimet në kursin e udhëtimit të mallit të siguruar
Neni 19	Njoftim i ngjarjes së sigurimit
Neni 20	Ruajtja e të drejtës për rekurs
Neni 21	Survejimi
Neni 22	Raporti i survejimit
Neni 23	Reklamimet
Neni 24	Afati i pagesës
Neni 25	Detyrimi i të drejtës për rekurs
Neni 26	Mosmarrëveshjet kontraktuale

A - FUSHA E SIGURIMIT

Neni 1. Format e Mbulimit

- 1.1 Sigurimi mbulon rreziqet ndaj te cilave mallrat jane te ekspozuara gjate udhetimit te siguruar, deri sa rreziqet specifike nuk jane perjashtuar shprehimisht.
- 1.2 Format kryesore të mbulimit janë: Mbulimi i rrezikut C, Mbulimi i rrezikut B, dhe Mbulimi i rrezikut A.

Neni 2. Mbulimi i rrezikut C

- 2.1 Ky sigurim mbulon humbje, dëme dhe shpenzime të objektit të siguruar, të shkaktuara nga:
 - 2.1.1 Zjarri, eksplozimi.
 - 2.1.2 Aksidente të mjeteve të transportit (*përplasje, nxjerrje në breg, fundosje, ngecje në cektinë, përmytje, dalje nga shinat*).
 - 2.1.3 Shkarkimi i mallit në portin e fatkeqësisë.
 - 2.1.4 Sakrifica e avarisë së përgjithshme.
 - 2.1.5 Humbje ose dëmtim i mallit nga sakrifica e avarisë së përgjithshme.
 - 2.1.6 Shpenzimet për shpëtimin e ngarkesës.

Neni 3. Mbulimi i rrezikut B

- 3.1 Përveç mbulimeve të rrezikut "C", ky lloj sigurimi mbulon edhe:
 - 3.1.1 Tërmetin, shpërthimin vullkanik, rrufenë.
 - 3.1.2 Rënia e ujit mbi bordin e anijes.
 - 3.1.3 Dëmtime nga uji i detit ose i lumit.
 - 3.1.4 Humbje totale e pakove të veçanta gjatë ngarkimit dhe shkarkimit.

Neni 4. Mbulimi i rrezikut A

- 4.1 Nuk emërtohen rreziqet por mbulohen të gjitha rreziqet e humbjeve ose dëmeve të shkaktuara nga çdo ngjarje e rastit, e paparashikuar, aksidentale dhe e papritur.

Neni 5 Përjashtimet në të 3 (tre) Format e mbulimit

- 5.1 Siguruesi në asnjë rast nuk mbulon humbje, dëme ose shpenzime të shkaktuara nga:
 - 5.1.1 Ngjarje që janë rrjedhojë e një veprimi të pandershëm, dhe/ose të paramenduar, dhe/ose të qëllimshëm dhe/ose neglizhencës së të Siguruarit dhe që duhej të parashikoheshin nga i Siguruari duke patur parasysh natyrën dhe rrethanat e këtij veprimi ose neglizhence.
 - 5.1.2 Rrjedhje e zakonshme, humbje të zakonshme në peshë dhe volum, konsum dhe amortizim i objektit të siguruar.
 - 5.1.3 Pamjaftueshmëria ose papërshtatshmëria e paketimit ose përgatitjes të objektit të siguruar.
 - 5.1.4 Vese të brendshme ose të natyrës të objektit të siguruar.
 - 5.1.5 Vonesa, edhe n.q.s. kjo është shkaktuar nga një rrezik i siguruar.
 - 5.1.6 Paaftësia paguese ose me karakter financiar, të pronarëve ose qiramarrësve të mjetit
- 5.2 Siguruesi në asnjë rast nuk mbulon humbje, dëme ose shpenzime të shkaktuara nga:
 - 5.2.1 Të gjitha llojeve të ndotjeve kimike
 - 5.2.2 Rrezatimit jonizues ose ndotjes radioaktive nga lëndë bërthamore ose rezervë bërthamore ose nga shpërthimi i lëndëve bërthamore;
 - 5.2.3 Lëndëve radioaktive, helmuese, shpërthyesë ose lëndë të tjera të rrezikshme apo ndotëse të instalimeve bërthamore, reaktorëve bërthamore apo njërive të tjera bërthamore ose elementeve bërthamore;
 - 5.2.4 Çdo armë lufte që shfrytëzon zbërthimin dhe/ose bashkimin bërthamor apo të ngjashme me to.
- 5.3 Për më tepër Siguruesi nuk është përgjegjës për: Pavlefshmërinë ose papërshtatshmërinë e anijes ose mjetit të transportit, kontenerit, vinçit shkarkues apo ngarkues, si dhe rrethanave të tjera, që kanë të bëjnë me kushtet specifike të ngarkimit, shkarkimit ose transportimit të mallrave.
- 5.4 Siguruesi në asnjë rast nuk mbulon humbje, dëme ose shpenzime si pasojë apo për shkak të efekteve

të drejtpërdrejta ose të tërthorta të ngjarjeve të cekura si vijon më poshtë:

- 5.4.1 Luftës të çdo lloji, me ose pa deklarimin e luftës, duke përfshirë të gjitha veprimet e dhunshme nga ana e shteteve dhe të gjitha veprimet dhe aktet e dhunshme të organizatave politike apo terroriste;
- 5.4.2 Veprimeve dhe masave të tjera ushtarake, pavarësisht nëse është deklaruar lufta ose jo;
- 5.4.3 Mina, silura, bomba ose armë të tjera luftarake të lëna nga lufta.
- 5.4.4 Predhës të çdo lloji apo tipi, të armës së zjarrit;
- 5.4.5 Turbullirave civile, luftës civile, revolucionit, rebelimit, kryengritjes, lëvizjeve separatiste, revoltave, puçeve, grushteve të shtetit, eksodeve.
- 5.4.6 Trazirave, protestave, demonstratave, grevave, sabotimeve, veprimeve/akteve keqdashëse, vandalizmit.
- 5.4.7 Kapja, mbajtja, konfiskimi, arrestimi, kufizimi ose pengimi dhe çdo pasojë ose përpjekje që lind nga kjo.
- 5.4.8 Gjobat, masat ndëshkuese.
- 5.5 Siguruesi në asnjë rast nuk mbulon humbje, dëme ose shpenzime të shkaktuara nga prishja, kalbja, dekompozimi i produkteve gjatë transportit të; pemëve (frutave), perimeve, mishit, produkteve të mishit, peshkut, qumështit, produkteve të qumështit, vezëve, vajit, yndyrnave ushqimore, bukës, brumërave, pijeve alkolike & pijeve të tjera, duhanit të përpunuar, sheqerit, çokollatës, ëmbëlsirave, kafes, çajit, kakaos, erëzave.

Neni 6.

Mjetet e Transportit

- 6.1 Siguruesi është përgjegjës për dëme dhe shpenzime lidhur me objektin e siguruar sipas parashikimeve të kontraktuara, në të gjitha rastet kur objekti i siguruar transportohet me mjete transporti, që sipas llojeve dhe tipeve, plotësojnë kërkesat e përmendura më poshtë, lidhur me aftësitë e tyre për të transportuar mallrat, në mënyrë të sigurtë.
 - 6.1.1 Mjetet e Transportit Detar: Pranoen të gjitha llojet që plotësojnë Klauzolat e Institutit të Klasifikimit të Londrës, dhe që drejtohet nga personi i pajisur me licensë drejtimi për llojin e anijes në fjalë. Për anijet me moshë mbi 15 vjet, Siguruesi do të aplikojë një prim shtesë, i përcaktuar më poshtë, por gjithmonë në vartësi të rugës që do të kryhet, dhe mallit që transportohet.
 - 6.1.1.1 Për anijet me moshë 16 – 25 vjet, primi i sigurimit rritet me 10%, nga aplikimi i tarifës përkatëse
 - 6.1.1.2 Për anijet me moshë 26 – 35 vjet, primi i sigurimit rritet nga 15 deri në 20% nga aplikimi i tarifës përkatëse, sipas marrëveshjes të palëve të interesuara.
 - 6.1.1.3 Siguruesi ka të drejtën për ta kërkuar dhe marrë këtë shtesë primi, në çdo kohë.
 - 6.1.2 Mjetet e Transporti Tokësor: Pranoen të gjitha llojet e mjeteve motorike, të cilat përmbushin

kushtet për t'u marrë në sigurim dhe mbajnë dokumentacionin e domosdoshëm, për të zhvilluar transport automobilistik, dhe që drejtohet nga personi i pajisur me patentë për llojin e automjetit në fjalë.

- 6.1.3 Mjetet e Transporti Ajror: Pranoen kërkesat për sigurim CARGO, për avion të licensuar nga organet ose autoritetet përgjegjëse, dhe që drejtohet nga personi i pajisur me licensë drejtimi për llojin e avionit në fjalë.

Neni 7.

Pjesa e Zbritshme

- 7.1 Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit do të aplikohet pjesa e zbritshme.
- 7.2 Masa e pjesës së zbritshme do të përcaktohet në Policën e Sigurimit.
- 7.3 Për çdo rast dëmi të trajtueshëm Siguruesi, sipas zgjedhjes së tij, do të zbresë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në përqindje ose në vlerë nominale.
- 7.4 Siguruesi është përgjegjës për të gjithë vlerën e çdo dëmi ose dëmeve të ardhura nga një ngjarje e vetme sigurimi dhe shpenzimeve të shkaktuara për të njëjtën ngjarje, kundrejt të Siguruarit ose Përfituesve të tjerë, kur vlera e dëmit ose e shpenzimeve kalon kufirin përjashtues (vlerën nominale), të përcaktuar në policën e sigurimit.

B - KONTRATA E SIGURIMIT

Neni 8.

Përmbajtja e Kërkesës

- 8.1 Kontrata e sigurimit lidhet në bazë të një kërkesë me shkrim nga ana e të Siguruarit, e cila duhet të përmbajë të paktën të dhënat e poshtëshënuara, të nevojshme për marrjen në sigurim:
 - 8.1.1 Përshkrimin e saktë të mallit, llojin e paketimit, peshën dhe numrin e pakove.
 - 8.1.2 Të dhënat e policë-ngarkesës (*numrat, datat*) ose dokumentave të tjera shoqëruese për transportin e mallit.
 - 8.1.3 Llojin e transportit (të dhëna të sakta zyrtare rregjistrimi për mjetin *psh në atë detar, emrin, vitin e ndërtimit dhe flamurin e anijes*).
 - 8.1.4 Vendin e ngarkimit, tranzitimit dhe arritjes së mallit
 - 8.1.5 Vlerën e mallit të siguruar.
 - 8.1.6 Kushtet e sigurimit të mallit

Neni 9.

Detyrimet e të Siguruarit

- 9.1 I Siguruarit ose personi i autorizuar prej tij, nënshkruan "pyetësorin" dhe policën e sigurimit dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e deklarimeve të bëra në to.
- 9.2 "Pyetësori" është formulari standart i përgatitur nga Siguruesi, të cilën i Siguruarit ose personi i autorizuar prej tij, e plotëson me kujdes dhe e nënshkruan së bashku me përfaqësuesin e Siguruesit.

- 9.3 I Siguruari, në kohën e lidhjes së policës së sigurimit, duhet të informojë me shkrim Siguruesin për të gjitha rrethanat e njohura prej tij dhe që janë thelbësore për vlerësimin e rrezikut.
- 9.3.1 Rrethanat janë thelbësore nëse ato janë të një natyre të tillë që mund të influencojnë në vendimin e Siguruesit për të lidhur ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendosë.
- 9.3.2 Nëse i Siguruari nuk e përmbush këtë detyrim, Siguruesi ka të drejtë të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit ose afatin e sigurimit, si dhe zgjidhjen e kontratës së sigurimit.
- 9.3.3 Siguruesi mund të zgjidhë marrëveshjen e sigurimit nëse i është dhënë informacion i gabuar.
- 9.3.4 Primi i sigurimit nuk i kthehet të Siguararit.
- 9.3.5 Në rast dëmi/humbje, Siguruesi lirohet nga detyrimi për dhënie dëmshpërblimi kur shkak i dëmit është një rrethanë që nuk i ishte bërë e njohur atij nga i Siguruari. Kjo dispozitë është e vlefshme edhe për Përfituesin.
- 9.4 Pas plotësimit të “pyetësorit” dhe lëshimit të policës, i Siguruari nuk mund të kryejë dhe/ose lejojë të kryhen ndryshime, të cilat sjellin shtimin e rrezikut, pa miratimin me shkrim të Siguruesit.
- 9.4.1 I Siguruari duhet të informojë menjëherë me shkrim Siguruesin për çdo shtim të rrezikut për të cilën vihet në dijeni, edhe nëse një shtim i tillë ndodh pa pëlqimin e tij.
- 9.4.2 Me shtim të rrezikut kuptohen rrethanat që janë thelbësore, të cilat mund të influencojnë në vendimin e Siguruesit për të përfunduar ose jo marrëveshjen, apo për kushtet që duhet të vendosë.
- 9.4.3 Në rast të moszbatimit të kushtit të mësipërm, Siguruesi ka të drejtë të lirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit. Kjo dispozitë është e vlefshme edhe për Përfituesin.

Neni 10.

Lidhja e Kontratës

- 9.1 Polica e sigurimit është dokumenti i nënshkruar dhe miratuar nga Siguruesi, që i lëshohet të Siguararit, me anë të së cilës vërtetohet lidhja e kontratës së sigurimit.
- 9.2 Siguruesi lëshon policën e sigurimit dhe përcakton primin e sigurimit në bazë të deklarimeve të dhëna nga i Siguruari tek “kërkesa për sigurim” dhe “pyetësori”. I Siguruari është përgjegjës lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të bëra prej tij.
- 9.3 I Siguruari dhe/ose Përfaqësuesi(t) e tij, me nënshkrimin e policës së sigurimi, nuk mund të justifikohet(n) në asnjë rast për mos njohjen e kushteve të përgjithshme të kësaj kontrate sigurimi.
- 9.4 Në rastin kur polica e sigurimit humbet ose dëmtohet në masën që konsiderohet e pavlefshme, atëherë me kërkesën dhe shpenzimet e të

Siguararit, Siguruesi duhet të lëshojë një dublikatë të saj

Neni 11.

Primi i Sigurimit

- 10.1 I Siguruari detyrohet t'i paguajë Siguruesit primin e sigurimit sipas shumave dhe afateve të përcaktuara në policën e sigurimit.
- 10.2 Pagesa e primit të sigurimit, ose e këstit të tij të parë ose e këstit në vazhdim të tij, do të konsiderohet e kryer në momentin e kalimit të shumës së caktuar në llogarinë e Siguruesit.
- 10.3 Sigurimi hyn në fuqi në orën 24:00 të datës së shënuar në policën e sigurimit, nëse në këtë moment primi i sigurimit ose kësti i tij i parë është paguar, në rast të kundërt hyn në fuqi në orën 24:00 të ditës së kryerjes së pagesës.
- 10.4 Në rastet kur Siguruesi ka rënë dakort, që i Siguruari të paguajë primin e sigurimit me këste, numri, vlera dhe datat e pagimit të tyre përcaktohen në policën e sigurimit.
- 10.4.1 Kësti vijues i sigurimit duhet të paguhet nga i Siguruari brenda 15 ditëve, nga data e lëshimit dhe marrjes së faturës, një kopje të nënshkruar të së cilës e merr Siguruesi. Në rast se kësti vijues i sigurimit nuk paguhet në afatin e përmendur më sipër, atëherë Siguruesi është i liruar nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit dhe ka të drejtë të pezullojë kontratën përsa kohë nuk kryhet pagesa, e cila rihyn në fuqi në orën 24:00 të ditës së kryerjes së kësaj pagese.
- 10.4.2 Në rast se kësti vijues i sigurimit nuk paguhet në afat, atëherë Siguruesi do t'i drejtojë të Siguararit një kërkesë me shkrim, për pagesën e obligimit brenda 15 ditëve mbas marrjes së shkresës, duke i deklaruar shumën e primit të sigurimit, kostot e borxhit, si edhe pasojat ligjore në rast mospagese.
- 10.4.3 Në rast se kësti vijues i sigurimit nuk paguhet në afatin e përmendur më sipër, mbas lëshimit dhe marrjes së faturës së kontratës dhe mbas kërkesës për pagesë, atëherë Siguruesi njofton përsëri me shkrim të Siguararin zyrtarisht. Kjo letër/shkresë e fundit duhet të tregojë shumën e kësteve të papaguara dhe datën kur duhej bërë pagesa dhe i tërheq vëmendjen të Siguararit për pasojat e mospagesës. Siguruesi ka të drejtë, 30 ditë mbas dhënies të këtij njoftimi, të ndërpresë kontratën dhe të këmbëngulë ligjërisht për përmbushjen nga i Siguruari të obligimeve financiare të saj
- 10.4.4 Në rast se kësti vijues i sigurimit nuk është paguar nga i Siguruari, atëherë në rast të ndodhjes të një ngjarje/rasti sigurimi, Siguruesi është i liruar nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit. Kjo vlen edhe në rast se, shkak i mospagimit të këstit të sigurimit nuk varej nga i Siguruari.

C – PERIUDHA E SIGURIMIT

Neni 12

Fillimi dhe përfundimi

Ky sigurim fillon nga koha qe mallrat levizin nga magazinat ne vendin e caktuar per fillimin e tranzitimit, vazhdon gjate kursit te zakonshem te tranzitimit dhe perfundon:

- Me dorëzimin te pritesi ose ne magazinën e perfundimtare ose ne vendin e magazinimit ne destinacionin e caktuar.
- Me dorëzimin ne nje magazine tjeter qe e zgjedh paraprakisht i siguruari ose ne vendin e destinacionit te caktuar per tu perdorur.
- Per depozitim ndryshe nga kursi i zakonshem i transportit, per dhenie ose shperndarje cilado qe te ndodhe e para.

Ky sigurim fillon nga koha qe mallrat lëvizin, drejt destinacionit të ngarkimit, transportit dhe përfundon:

- (a) Me dorëzimin tek Pritësi ose në vendin e rënë dakort në Kontratë (policën e sigurimit).
- (b) Për depozitim ndryshe nga kursi i zakonshëm i transportit.
- (c) Për dhënie ose shpërndarje, cilado që të ndodhë e para.

Neni 13

Vonesa

Ky sigurim do të mbetet në fuqi gjatë vonesave përtej kontrollit të të Siguruarit, për çdo devijacion, shkarkim të detyruar, ringarkim ose ritransportim dhe gjatë çdo ndryshimi në avari detare, që lindin nga e drejta që u lejohet pronarëve të anijeve ose qirramarrësve në bazë të kontratës së transportit.

D - PËRCAKTIMI I VLERËS

Neni 14

Vlera e sigurimit

- (a) Vlera e sigurimit është vlera e mallrave në kohën dhe vendin e fillimit të udhëtimit duke i shtuar shpenzimet e transportit, primin e sigurimit dhe shpenzime të tjera të bëra deri në destinacion, përfshirë 10% të fitimit të shpresuar.
- (b) Vlera e zëvendësimit është ajo të cilën mallrat kishin patur në destinacion në kohën e ndodhjes së humbjes ose dëmit. Në mungesë të dëshmisë vlera e zëvendësimit është pranuar t'i korrespondojë vlerës së siguruar.

Neni 15

Shuma e siguruar

Shuma e Siguruar konsiston në limitin e të gjitha dëmshpërblimeve për humbje ose dëme të shkaktuara nga një ose më shumë ngjarje.

Neni 16

Sigurimi i pjeshëm

Në qoftë se shuma e siguruar është më e ulët se vlera e zëvendësimit, Siguruesi është përgjegjës vetëm për përpjestime të tilla të humbjes ose dëmit, sa shuma e siguruar qëndron ndaj vlerës së zëvendësimit.

E – DETYRIME

Neni 17

Paraqitja e të dhënave

(a) I Siguruari është i detyruar të paraqesë vullnetarisht Siguruesit, të gjitha rrethanat që ndikojnë në vlerësimin e rrezikut (që përbëjnë risk).

(b) I Siguruari është i detyruar të japë të gjitha të dhënat që i kërkohen nga Siguruesi, përjashtuar ato që i përmban Kërkesa.

(c) Të gjitha të dhënat e kërkuara nga Siguruesi janë të detyrueshme të jepen, e të domosdoshme për të Siguruarin

Neni 18

Ndryshimet në kursin e udhëtimit të mallit të siguruar

(a) Kur mbas nënshkrimit të kontratës së sigurimit, ndryshohet drejtimi i udhëtimit nga i Siguruari, do të ketë mbulesë sigurimi, por me kushtin që t'i jepet njoftimi me shkrim, i menjëhershëm Siguruesit dhe kur palët bien dakort për pagesën e primit shtesë, për ndryshimin e drejtimit.

(b) Në rast se për shkak të disa rrethanave, përtej kontrollit të të Siguruarit, kur kontrata e transportit përfundon në një port ose vend ndryshe nga destinacioni i caktuar, atëherë ky sigurim do të përfundojë po të mos i jepet njoftim me shkrim, i menjëhershëm Siguruesit dhe të mos kërkohet vazhdimësia e mbulesës. Ky sigurim do të mbetet në fuqi kundrejt pagesës të një primi shtesë, nga i Siguruari.

Neni 19

Njoftim i ngjarjes së sigurimit

I Siguruari duhet të njoftojë Siguruesin brenda 48 orëve nga moment i ndodhjes të ngjarjes së sigurimit dhe të marrë pa vonesë të gjitha masat për ruajtjen dhe shpëtimin e mallrave dhe për minimizimin e humbjes ose dëmit.

Neni 20

Ruajtja e të drejtës për rekurs

I Siguruari është i detyruar të ruajë të gjitha të drejtat për rekurs, kundrejt personave të tretë, të cilët mund të jenë përgjegjës për dëmin ose humbjen dhe përgjigjet për çdo veprim që cënon të drejtën e rekursit.

Në veçanti i Siguruari duhet të marrë këto masa:

- (a) Dëmet e dukshme i njoftohen me shkrim Transportuesit, përpara marrjes në dorëzim të mallrave.
- (b) Kur mendohet se ka dëme, të bëhen rezervimet e nevojshme brenda afateve ligjore ose të parashikuara në kontratë.
- (c) Kur ka mosmarrëveshje për përcaktimin e madhësisë së dëmit, për vërtetimin e tij thirret edhe Transportuesi.

Neni 21

Survejimi

Në rast humbjes apo dëmsh, që përbëjnë rast sigurimi, ose dyshon se ka ndodhur një gjë e tillë, i Siguruari njofton menjëherë Siguruesit ose Survejtoret e miratuar prej tij, të cilët hartojnë raportin e inspektimit mbi gjendjen faktike të mallit. Në qoftë se humbja ose dëmi nuk janë të dukshme nga ana e jashtme, survejimi duhet të kërkohet

brenda javës së dorëzimit të mallit të Pritësi, kur edhe ai është i mbuluar në sigurim.

F – VLERESIMI I HUMBJES OSE DËMIT DHE REKLAMIMET

Neni 22

Raporti iurvejimit

Raporti i Survejimit hartohet nga Eksperti(ët) ose Survejori(ët) e autorizuar. Raporti i Survejimit përshkruan me hollësi dhe përmban informacione të sakta mbi vlerën e humbjeve, shkaqet e humbjeve apo të dëmeve, dëshmi të Transportuesit dhe të Personave të autorizuar, që vërtetojnë dëmet apo humbjet.

Neni 23

Reklamimet

Reklamuesi duhet të provojë që në drejtimin e udhëtimit të siguruar, mallrat pësojnë humbje ose dëm për të cilin Siguruesi është përgjegjës.

I Siguruari do të paraqesë deklaratën e reklamimit së bashku me të gjitha dokumentet e nevojshme si:

- (a) Polica origjinale e Sigurimit.
- (b) Fatura origjinale e mallit.
- (c) Fletë-ngarkesa origjinale.
- (d) Raporti origjinal iurvejimit.
- (e) Raporti i ekspertit.
- (f) Çertifikata e origjinës.
- (g) Proçes-verbalet me transportuesin.
- (h) Llogaritja e madhësisë së dëmit.
- (i) Proçes-verbalin e rivlerësimit (në rastin kur bëhet rivlerësimi) të mallrave të dëmtuara, që kanë vlerë përdorimi.
- (j) Si dhe dokumenta, që mund t'i shikojë të arsyeshme Siguruesi.

G - KERKESA LIGJORE

Neni 24

Afati i pagesës

I Siguruari ka të drejtë të kërkojë nga Siguruesi, dëmshpërblimin brenda 24 muajve nga data e lindjes së kësaj të drejte.

Neni 25

Detyrimi i të drejtës për rekurs

I Siguruari i njeh Siguruesit, të gjitha të drejtat kundrejt palëve të treta.

- (a) E drejta kundrejt palëve të treta bëhet efektive, sapo që Siguruesi ka plotësuar detyrimin e tij të pagesës së dëmshpërblimit.
- (b) Kur i Siguruari merr nga persona të tretë, një pjesë të dëmshpërblimit për dëmin e pësuar, Siguruesi detyrohet t'i paguaj atij vetëm diferencën.

Neni 26

Mosmarrëveshjet kontraktuale

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga kontrata e sigurimit, ndërmjet Siguruesit dhe të Siguarit, zgjidhen nga Gjykata, kompetente e vendit ku lidhet kontrata e sigurimit.

Kur i Siguruari është person juridik ose fizik i huaj, mosmarrëveshjet do të zgjidhen në përputhje me legjislacionin e vendit për të cilin bihet dakort midis palëve me nënshkrimin e kontratës.